
THIRRJE PËR APLIKIME

Sipërmarrja sociale si risi në punën e organizatave të shoqërisë civile

Qëllimi i projektit është të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshmërisë së shoqërisë civile duke forcuar kapacitetet e organizatave për të përfshirë komponentin dhe vlerat e sipërmarrjes sociale në punën e tyre. Projekti është mbështetur nga Ambasada Britanike në Shkup, i zbatuar nga Fondacioni Metamorfozis.

Programi

Aktiviteti 1:

Dhjetor 2016 – Janar 2017: Lokalizim i materialeve për sipërmarrësi sociale

Aktiviteti 2:

Janar 2017: Publikimi i thirrjes për organizatat të cilat do të marrin pjesë në trajnimet për sipërmarrësi sociale

Aktiviteti 3:

Shkurt – Mars 2017: Organizimi i trajnimeve për futjen e konceptit të sipërmarrësisë sociale në organizatat civile.

Në trajnim do të marrin pjesë 20 përfaqësues nga organizata civile nga të gjitha qytetet e Maqedonisë. Trajnimi përbëhet nga 7 module të cilat do të mbulohen/kalohen për 4 ditë nga 4 orë:

- MODULI 1. Krijimi i një bote më të mirë
- MODULI 2. Krijimi i ndryshimeve sociale
- MODULI 3. Lidhjet me palët e interesuara
- MODULI 4. Spjegimi i kualitetit dhe ndikimit
- MODULI 5. Kuçja e qytetarëve dhe udhëheqësia
- MODULI 6. Arritja e qëndrueshmërisë financiare
- MODULI 7. Planifikimi i sipërmarrjes sociale.

Pjesëmarësit në trajnim do të duhet të definojnë idetë konkrete për biznes social në fushën e punës së organizatave nga të cilat vijnë dhe të njejtit të zhvillojnë biznes-plan, me fokus të veçantë në mirëmbajtjen e komponentës financiare.

Aktiviteti 4:

Prill 2017: Garë për biznes-plan dhe prezantim publik i biznes ideve sociale.

- Pjesëmarësit në trajnim do të duhet që biznes-planet e tyre ti dorëzojnë në Institutin ZIP për kontrollë në afat kohor të caktuar, ngaqë ekipi i pavarur i organizatës do të zgjedh biznes-planin më të mirë.
- Biznes-plani i cili sipas të gjitha parametrave, do të jetë më kualitativ dhe më i realizueshëm, do të shpërblehet me mentorim gjatë procesit të implementimit në kornizat e organizatës.
- Edhe pse shpërblimet financiare janë shtytje më e madhe për organizatat që të aplikojnë dhe të marrin pjesë në disa gara dhe konkurse, në këtë projekt me qëllim është larguar shpërblimi financiar. Qëllimi i kësaj gare, si dhe vetë projekti është që organizatat të mendojnë si “Sipërmarrës” dhe të krijojnë vlera me burimet e limituara.

Aktiviteti 5:

Prill – Maj 2017: Mentorim

- Organizata me biznes-planin fitues do të shpërblehet me 30 orë mentorim nga ana e ekspertëve, me qëllim korigjimin e biznes planit si dhe implementimin e duhur në punën e organizatës

Kriteriumet për zgjedhje

- Organizatat civile që punojnë në Republikën e Maqedonisë
- Organizatat që nuk egzistojnë më shumë se 10 vjet dhe kanë më pak se 10 të punësuar Përparësi do të kenë organizatat që kanë mungesë të modelit financiar për mirëmbajtjen e tyre dhe janë të varur nga financimi i projekteve të tyre nga ana e donatorëve lokal ose të jashtëm
- Projekti do ti kyqë dhe promovojë sipërmarrësit shoqëror si dhe organizatat që kanë pranuar konceptin e sipërmarrësisë sociale në punën e tyre, si shembuj pozitiv dhe bashkëpunorë që do ti propagandojnë qëllimet e projektit.
- Kandidatët e rekomanduar të mos jenë në moshën nën 23 vjeçare
- Organizata merr përgjegjësinë se kandidati të cilin e nominojnë do të merr pjesë në të gjitha aktivitetet e programit.

Si të aplikoni?

Me qëllim që të aplikoni në këtë program ju lusim që të dërgoni dokumentet në vijim:

- CV për kandidatët e nominuar nga organizata juaj (maks. 2 kandidatë nga një organizatë)
- Letër rekomandimi për kandidatët e nominuar (me nënshkrim dhe vulë)

Dokumentet për aplikim do të duhet të dërgohen më së voni deri më datë 13 Shkurt 2017, në info@zipinstitute.mk